

NACIONAL

Gazetë javore, letrare & kulturore, e përditshme online

Botues: Mujë Buçpapaj
e-mail: bucpapaj@yahoo.com

Mob: 068 20 74 316

www.gazeta-nacional.com

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
e-mail: nacionalalbania@yahoo.com

Flet poeti dhe përkthyesi i mirënjohur shkupjan

Mustafa Spahiu: Poezia elitare shqipe udhëheq poezinë ballkanike

faqe 18-19



Poetessa flet për librin e saj të ri me poezi

Fleta Snalla: Ky libër është si fëmija i shpirtit për mua

faqe 28



EDITORIAL

Gjellë pa shije, me pak erëz "UNESKO"

Nga Mehmet ELEZI

Ministria e Kultures po inventarizon pasuritë kulturore jomateriale. Drejt UNESCO-s do të shkojnë katër propozime: vallja e Tropojës, bjeshkimi dhe dihebërja e xhubletës. Rinis dhe dosja e Eposit. Kështu citon media një zëvendësministre.



faqe 23

Mali i Zi rast i veçantë në regjion

Nga Dr. Nail Draga

Në vendet demokratike me pushtet të konsoliduar rrotacioni politik është dukuri normale, që është në favor të demokracisë dhe të pluralizmit, ndërsa përjashtim bëjnë vendet autoritare me animozitetet



Çamëria në aktualitetin shqiptar dhe evropian

Nga Ahmet MEHMETI

Situatat me pandemi nga Covid-19 nuk kanë penguar njerëzit e letrave që të shkruajnë, madje edhe të botojnë libra. I tillë ka qenë libri "Çamëria, toka pa njerëz, njerëzit pa tokë" i publicistit elbasanas Hyqmet Zane. Është një përmbledhje



faqe 23

30 vjet nga botimi i poezisë disidente "Kujt", në gazetën "Drita"

Poezia "Kujt" e Gjekë Marinajt shënoi fundin e realizmit socialist

STUDIM NGA MUJË BUCPAPAJ

faqe 30-31



Fotoja e parë që bëri Gjeka ditën kur u botua poezia Kujt në gazetën Drita



POEZIA KUAJT, KONSIDEROHET IKONA MË E BESUESHME POETIKE QË PASQYRON REALITETIN SHQIPTAR GJATË PERIUdhës SË DIKTATURËS

Studim nga Senada Demushi (Delaj)

ORA E FUNDIT TË TË DËNUARIT ME VARJE, HAVZI NELA

Tregim i jetuar nga Bedri Blloshmi

FAQE 8

SHKRIMTARIT SAMI MOLLOSHI BOTON NË SHBA LIBRIN E RI ME TREGIME

Nga Genc Tirana

FAQE 31

NËBRENDËSI

FAQE 5
POEMË NGA GUSTAVO V. MANSILA
Përktheu NATASHA XHELILI

FAQE 4
NË POSTËN HUNGAREZE
Tregim satirik nga JAROSLLAV HASHEK

FAQE 8
NJERËZ NORMALË
Roman nga SALLY ROONEY

FAQE 10
PYETJE ZOTIT
Poezi nga ASJA MULGECI

FAQE 6-21
Prozë nga:
FERIDE PAPLEKA • QAZIM NAMANI
LIRI PONE BELE • MILTIADH DAVIDHI
PETRIT BRAHOLLARI • ORHAN SAKIQI

FAQE 6-21
Poezi nga:
SIBORA HUDA • QAZIM SHEHU
ALBANA ZIRKA • SHPRESA DHIMA
ENRIETA SINA • FATMIRE THAÇI

+355 4 4500001/ 4500002
+355 66 20 70 659
Rr. "Papa Gjon Pali II",
Vila Nr. 5, Tiranë-Shqipëri
P.O. Box Nr. 126
info@eurosig.al

EUROSIG
KOMPANI SIGURIMESH
SIGURI E STANDARDEVE EUROPIANE




Lindi-AL
FOOD PRODUCT
355692099886
www.lindi-al.com

Hilton
Garden Inn™
Tirana

Poezia "Kujt"- "Fatsjellësja" e Gjekë Marinaj

POEZIA KUAJT, KONSIDEROHET IKONA MË E BESUESHME POETIKE QË PASQYRON REALITETIN SHQIPTAR GJATË PERIUDHËS SË DIKTATURËS

"Menjëherë pas botimit të kësaj poezie, njerëzit filluan ta kopjonin në copa letrash dhe ta recitonin fshehurazi"



Studim nga Senada Demushi (Delaj)

Cindy Hulbert

"Një ditë, në klubin e Lidhjes së Shkrimtarëve tek po bisedonim me shkrimtarët Nasi Lera e Zija Cela, njohëm Gjekë Marinajn, një djalosh 22-vjeçar nga Bajza e Kastratit të Shkodrës. Patëm rastin të zbulojmë tek ai poetin nga leximi i fletores së tij poetike të cilën mezi ia "zhvatëm" duke thyer "barrierën" e modestisë. "Merrenoci, se ty të takon t'ia kthesh kënaqesinë që na dhuroi leximi i poezive të tij më të mira",-më tha Nasi Lera. Dhe une po e kryej porosinë pa shtëzim në mardhenie me vetveten, sepse poezitë e tij më pëlqyen dhe pashë tek ai fillestarin e jorëndomtë. Nuk po flas për vlerat e poezive të Gjekës. Jam i bindur se nuk po tregohem një ndërmjetës i keq apo sentimental në mes poetit të ri dhe gazetës "Drita" e lexuesve." [1]

Gazeta "DRITA", 19 Gusht 1990


Kështu e fillon Ndoc Gjetja faqen nr.10 të gazetës "Drita" të datës 19 Gusht 1990 tek rubrika "Autorë të rinj", duke botuar me poshtë katër poezi të Gjekë Marinaj, përkatësisht ato me tituj : "Mos më ik larg, poezi", "Vonesa e motrës", "Të paktën në ëndërr..." dhe poezia e fundit e botuar atë dite vere ishte ajo me titull "Kujt".

Më poshte poezia:

"KUAJT"

Tërë jetën duke vrapuar rrimë

Shohim veç përpara
Ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë.
Ne nuk kemi emër
Të gjithëve kuaj na thonë.
Nuk qajmë,
Nuk qeshim;
Heshtim,
Dëgjojmë;
Hamë atë ç'na japin,
Ecim nga na thonë,
Asnjë nga ne s'është mendje hollë.
Kush qe kalë mbreti,
Posti qe i lartë
Kush qe kalë princeshe
I bënë shalë të artë
Kush qe kalë fshatari
Pat samarë me kashtë
Kush qe kalë i egër
Tërë jetën fjeti jashtë.
Po qemë dhe mbetem kuaj, para njeriut



Menjëherë pas botimit të kësaj poezie, njerëzit filluan ta kopjonin në copa letrash dhe ta recitonin fshehurazi e ta shpërndanin tek njëri-tjetri me shpejtësinë e drites, ndryshe nga shume shkrimtarë të tjerë të cilët tentonin të futeshin në mëndjet e njerëzve prej vitesh me botimet e tyre në gazetë e kohës. "Ishte viti kur njerëzit përjetonin një atmosferë mbytëse, absurde, fyese, groteske. Në Shkoder trupat të vrarëve në fuqi i tërhiqnin zvarrë përpara syve të shqyer të njerëzve. Turmat rrinin në rradhë me shpresën se mund të blihej një shishe qumësht. Nëpër trena, gjatë udhëtimit, njerëzit shkulinin dërrasat e dyshemesë e ndiznin zjarre. Cdo gjë ishte kundër letërsisë dhe poezisë. Të zënë me preokupimet më banale të jetës, dukej se kujtimi i poezise, i fantazisë, i ndjenjave, i fyente njerëzit. Cuditërisht në këtë atmosferë aq të kobtë, njerëzit thërrisnin në ndihmë poezinë. E vetmja rradhë që nuk i fyente njerëzit ishte pritja për të blerë gazetën e shkrimtarëve. Dhe në po atë gazetë në një cep të saj, lexuesit e vëmëndshëm vunë re një poezi të titulluar "Kujt" dhe emri i autorit ishte Gjeke Marinaj. Poezia pati një jehonë të jashtëzakonshme. Nëpër trenat e djegur ku kishin mbetur vetëm skeletet metalike njerëzit nxirrnin nga xhepat një letër të zhubrosur ishte kopjuar poezia "Kujt". Ajo ishte një poezi e shtruar në mënyrën më naive, me një shkujdesje ritmike dhe e paorganizuar deri në fund. E megjithatë fatin e saj do ta kishin dëshiruar edhe poezitë më të qëndrueshme antologjike" [2]

Kështu do thoshte pas 20-viteve shkrimtari, poeti dhe publicisti i njohur, njëri ndër të parët që e ka afruar Gjekën për talentin e tij, Rudolf Marku. Është po ky i njëjti person i cili pas një viti riboton edhe një here poezin "Kujt" ne po të njëjtën gazetë bashkë me disa poezi tw autoreve të tjere "plangprishës të diktaturës", për të cilët shkruan enkas një artikull nën titullin "Sfida poetike". "Poeti i ri njëzet vjeçar u detyrua të kapërcente kufirin, edhe pse kjo gjë mund të paguhej me kokë". [3]

Është Rudolf Marku përsëri ai njeri i cili mban firmën e vet në redaktimin dhe parathënien e vëllimit të parë me poezi të Gjekës, atë me titull "Mos më ik larg", vëllim ku përfshihet edhe poezia më e famshme e Gjekës, ajo me titull "Kujt". "Në anën tjetër të botës, në Teksas, Gjekë Marinaj ka përgatitur këtë vëllim poetik. Dëshëronte ta botonte këtu, për të vazhduar dialogun poetik të nisur me "Kujt". Hapsira mes Bajzës dhe Dallasit, mes Shqipërisë dhe Teksasit, mes Ballkanit dhe SHBA-së është një fiksim irreal. Sepse po t'i besojmë Gjekës deri në fund, poetët janë kurdoherë më të gjërë nga hapsira". [4]

Shefqet Dibrani, një tjetër njeri i vëmëndshëm ndaj këtij autori dhe në vecanti të poezisë "Kujt" shkruan njëzet e një vite më vonë për simbolikën që ka kali në poezinë e Marinaj dhe vetë kali si kafshë në përgjithësi. "Kujt e këtij vargu poetik janë figurat e gjalla njerëzore që veprimet e tyre ngjasojnë me ato të kuajve të rëndomtë, sepse sic thote autori:

"Tërë jetën duke vrapuar rrimë

Shohim veç përpara

Ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë".

Çështje e vërteta kuajt janë kafshë e fortë njëhundrake, të forta dhe të shkathëta, me trup të madh, mbuluar me qime të buta e të shkurtëra, me bisht të gjatë e me jele, që shërbejnë për t'u hipur në shpine për transport e për të vrapuar. E po hyzmeçarët e pushtetit diktatorial çfarë ishin: Ata ishin njerëz që mbathnin këpucë, sandale por më shumë cizme. Numri dhe formati i tyre nuk përcaktohej, as nga taket që lenin gjurmët e ndryshme, të cilat ngjasonin me ato të njëthundrorëve nuk përcaktoheshin". [5]

Arsyetimi i tij vazhdon më tutje... "Ata ishin tjetërsue tamam në kuaj ku ju hipnin e ju zbrisnin sa herë që të donin eprorët e tyre". [6]

"Po ashtu kuajt janë kafshë, emrat e të cilëve na japin mundësinë figurative për të shpjeguar shumë çështje, për të injoruar apo në menyrë figurative për të akceptuar se nuk e coi deri në fund një punë të nisur. Kur binte nga pozita e lartë që kishte dikush, pra e shkarkonin nga puna nga ndonjë post gjithmonë thuhej se ra nga kali. Prandaj autori me të drejtë konstaton për emëruesin e përbashkët:

"Të gjithëve kuaj na thonë.

Nuk qajmë,
nuk qeshim,
dëgjojmë,
hamë atë ç'na japin,
ecim nga na thonë...",
dhe të gjitha këto veprime janë të përgjuara nga instinkti i vet lëvizjes sepse "asnjë nga (kuajt)

30 vjet nga botimi i poezisë disidente “Kuajt”, në gazetën “Drita”

NGA MUJË BUCPAPAJ

Gekë Marinaj me poezinë “Kuajt” të botuar në gazetën “Drita” më 19 gusht 1990, paralajmëroi fundin e realizmit socialist në Shqipëri. Poezia “Kuajt” u shndërruar aq shpejt në kredon e një brezi të rinjsh që po kërkonin ndryshim, në fakt paralajmëroi rënjen e vetë regjimit stalinist të Tiranës, çfarë do të ndodhte vetëm pak muaj më vonë, në dhjetor 1990.

Në brez poetësh të rinj të stileve dhe të përvojave të ndryshme letrare, në fund të viteve 1980 po bënin përpjekje të konsiderueshme që të mos identifikoheshin me socializmin. Marinaj me poezinë Kuajt në këtë kuptim, iu kundërvu hapur asaj që thirrej si “tematikë e kongreseve dhe plenumëve.”

Marinaj preferoi goditjen e sistemit nëpërmjet ironizimit të njeriut të ri të nënshtruar që nuk kishte të drejtë as të mëndonte, por të ecnte pa menduar përpara si kalë karroce, krejt ndryshe nga brezi i dy dekadave më parë që preferoi poemat epike dhe epike-lirike me ngarkesë të madhe ideologjike që i bënin jehonë politikës së ditës.

Marinaj hyri në letërsinë shqipe kur sistemi politik ishte konsoliduar me tiparet e një diktature monopartiake ekstremiste, ndërsa sistemi letrar i kishte përcaktuar rregullat, parimet, bilës edhe rendin brenda hierarkisë poetike. Ishte përcaktuar modeli i poezisë lirike, i poezisë afirmative, i poezisë tribunale të tipit “bomb dhe flamur” i poemës politike dhe asaj të entuziazmit, duke lënë pak hapësirë për ndryshim.

Poezia “Kuajt” vinte në kundërshtim me poezitë e toneve të rënda politike që buronin nga parimet estetike të realizmit dogmatik shqiptar dhe shtysat politike që nxisnin poetët dhe shkrimtarët të lëvronin temat e parapëlqyera nga regjimi.

Marinaj duke zgjedhur të dilte jashtë rregullave të paracaktuara, në mënyrë të vetëdijshme zgjodhi konfrontimin me sistemin dhe kritikën ideologjike të tij.

Marinaj duke botuar një poezi denoncuese ndaj njeriut të ri të socializmit shqiptar, e diversikoi poezinë shqipe duke qënë një zë ndryshe. Sido që në fund të sistemit monist, ajo shërbeu për të ndërgjegjësuar të rinjtë shqiptarë për të dalë nga rreshti uniformë dhe kundërvnë regjimit që shtypte liritë dhe të të drejtat themelore të njeriut.

Ai inspiroi një sistem të hapur letrar dhe rënd pluralist, por u përball me ndërhyrjen e fortë të politikës së kohës, dhe kërcënimet veglave të diktaturës të cilat po mbanin akoma në këmbë qeverinë komuniste të Tiranës, ndërsa pluralizmi kishte mbërritur përgjatë gjithë Europës Lindore.

2.

E gjithë letërsia që shkruhej në Shqipërinë shtetërore ishte konfirmuese e arritjeve të socializmit. Brezi i viteve 1970

në ndryshim nga pararendësit, poezinë afirmative, apo poezinë e entuziazmit revolucionar për industrializimin, elektrifikimin, apo ndryshimet socialiste që kishin përfshirë vendin, e realizuan me mjete poetike, duke e mbajtur poezinë si zhanër të letërsisë dhe jo të politikës, të sloganeve të kohës siç ishte rrezikuar vërtetë në atë kohë. Por nuk guxoi t'i kundërvijeh sistemit.

Marinaj bëri një kapërcim të madh dhe të guximshëm. Jo vetëm që nuk zgjedh një dykuptimësi fjalësh dhe figurash për të shprehur disidencën estetike, por përmes simbolit të kalit të punës të nënshtruar, që tërhiqet nga kapistra nga padroni, në fakt portretizoi një popull të nënshtruar dhe të gjunjëzuar para diktaturës. Tashmë në Europën Lindore kishin rënë regjimet komuniste ndërkohë udhëheq-

Poezia “Kuajt” e Gjekë Marinajt shënoi fundin e realizmit socialist



“Marinaj me poezinë “Kuajt” identifikohet si një poet i lirisë dhe i revoltës qytetare kundër totalitarizmit. Ai përmes metaforës së kuajve të bindur, ironizoi nënshtrimin fatal ndaj diktaturës për shkak të frikës dhe masave shtërnguese që perdorte ajo. Poezia, nxiti revoltën, ngritjen krye kundër shtypjes staliniste, evokoi lirinë si një ndjenjë të përbotshme kundër nënshtrimit, çfarë e bën atë një poezi të gjithëkohshme dhe vetë Marinajn një poet universal.”

ja e lartë e Tiranës vijonte me sloganet që “Shqipëria nuk është as lindje dhe as perëndim”, që “as nuk hapet dhe as nuk mbyllet”, e të tjera slogane që kishin revoltuar në masë rinjtë shqiptarë.

Poezia futuro-socialiste e Frederik Rreshpjes për elektrifikimin dhe aksionet, poezia hermetiko-lirike e Moikom Zeqos për mbjelljen e ullinjve, poezia surrealiste e Skënder Buçpapajt për qytetet punëtore, poezia e meditimit afirmativ të Ndoc Papekës për digën e Fierzës dhe modeli i poezisë antropocentriste të Xh.Spahiut, F.Halitit dhe Sadik Bejkos, R.Markut, H.Aliajt, përbëjnë një ndryshim të madh në poezinë shqipe të kohës me këto tema. Por ata nuk mund të dilnin aq hapur kundër sistemit, sic bëri Gjekë Marinaj me poezinë “Kuajt”.

Lirizmi impersionues i këtij brezi e demil-

itarizoi poezinë revolucionare të kohës, duke i dhënë trajtë poetike të lartë dhe stil të ri modern, pra një fytyrë njerëzore.

Ndërkohë që poezia e Marinajt, e botuar kur sistemi ishte akoma kërcënues dhe i rrezikshëm, kur kishte debuar më dhjetra vjet burg një grup disidentësh politikë që kishin rrezuar bustin e Stalinit në Shkodër me 13 janar 1990 dhe vriste në kufij të rinjtë që kërkonin të kapërcenin telat me gjemba, kur dy vjet më parë kishte varur në litar poetin disident Havzi Nela, e profilizoi Marinajn si një poet të guximshëm dhe rebel.

Poezia “Kujat” e ndihmoi letërsinë shqipe dhe posaçërisht poezinë për t’iu drejtuar së ardhmes dhe komunikuar normalisht me një lexues tjetër që edhe sot pas 30 vjetësh, kur ngrehinat ideologjike që mbanin në këmbë realizmin socialist kanë rënë dhe procesi letrar është hapur ndaj çdo mundësie dhe prirje estetike, si një

poezi që mbart vlera, të lexohet akoma më shumë vemendje.

Ky fakt është një tregues i fortë i një ndryshimi esencial i poezisë së kohës, i arritur përmes polemikash dhe mosbesimi të kritikës së kontrolluar si dhe pasojave që poetët patën për shkak të daljes nga rregulli.

Poezia “Kuajt” e realizuar përmes mjeteve strikte letrare, poetike, shënoi një prirje e re të poezisë së kohës, duke e vënë sistemin diktatorial në alarm dhe për këtë shkak sigurimi i shtetit e vuri poetin në shenjetër për ta arrestuar, duke e detyruar atë të ikte nga vendi për të gjetur siguri jashtë shtetit.

3.

Poezia Kujt, është një poezi e revoltës njerëzore e distancuar nga zhvillimet brohoritëse, sociale dhe politike, sloganet dhe parrullat përkatëse. Kjo poezi i dha fund realizmit socialist shqiptar, poezisë tribunale të kohës duke qënë një ndryshim i madh, por që i kushtoi autorit arratisjen jashtë vendit. Vetëm dy muaj më vonë në fund të tetorit 1990 shkrimtari i shquar Ismail Kadare u arratis nga Shqipëria si i vetmi mjet që kishte mbetur në dorë për të shprehur mospajtimin e tij me udhëheqjen komuniste të Tiranës e cila nuk po jepte asnjë shenjë se do të hapte vendin dhe pranonte pluralizmin politik.

Poezia “Kuajt” shënoi një zhvillim të ri në poezinë shqipe që e solli me shumë talent dhe kurajë Marinaj.

Terminologjia politike, frymëzimi i skajshëm ideologjik dhe përfshirja e poezisë në aksionet apo fushatat politike, e kishte shndërruar vetë poezinë në një tip gazete ditore apo kronike lajmesh nga kantieret dhe fabrikat, duke i mohuar poezisë shpirtin e saj lirik, mediativ, njerëzor dhe mistikën e frymës së përjetshme të dashurisë, jetës, mallit dhe vdekjes, apo revoltës qytetare.

Njeriu i ri as që duhej të dyshonte tek drejtësia e vijës së partisë dhe në këtë kuptim denoncimi i Marinajt, ironia therrëse e kuajve të bindur, e fut poezinë tonë në një fazë të re të clirimit të saj nga ngarkesat ideologjike dhe kërkimit të lirive politike, shoqërore. Kjo nuk kishte ndodhur më parë në poezinë shqipe.

Më parë epizmi i Luftës dhe në vitet 1960 epizmi politik dhe lufta ideologjike ndërkombëtare, ku ishte përfshirë regjimi, kishin shërbyer si nxitje për shumë poetë për të dalë me poema të mëdha luftarake, epike ku amplifikoheshin fitoret e partisë “në luftë me armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm.” Kjo lloji poezie e kishte denaturuar atë dhe larguar nga ndjesia njerëzore. Në fakt sic vëren edhe akademik Shaban Sinani, këta poetë i bënë shumë dëm, sidomos zhanrit të poemës, pasi krijuan një model shabllon të ngrirë, atë të poemës luftarake politike, të stilit të Majakovskit tek poema për Lenin, një model që mbeti i pandryshuar deri në vitin 1990.

Marinaj vuri shpirtin e tij në poezinë Kuajt duke sjellë jetën, qënien, vetveten, në një dimension që dilte nga skaneri partiak i kontrollit të jetës deri në pafundësi.

Kontrasti i saj ishte i fortë dhe i dukshëm si jetë njerëzore dhe fizike, pasi kjo poezi solli edhe mistikën e lirisë dhe dyshimit tek socializmi, tek udhëheqja e cila e quante vetën të pagabueshme.

4.

Mendoj se poezia Kuajt, solli një ndryshim të dukshëm dhe të verifikueshëm në

letërsinë e kohës. Ajo e nxori poezinë nga ugari revolucionar i njeriut që mendonte vetëm për fitoren e revolucionit duke e sjellë atë në një bazë të qëndrueshme humane, intelektuale të revoltës së përjetshme dhe kërkimit të lirisë.

Ky poezi u konsiderua nga politika dhe instucionet e diktaturës si një humbje e besimit tek partia dhe deformim i njeriut të ri i cili ishte përkushtuar luftës për ndërtimin e socializmit dhe për fitoren përfundimtare të komunizmit.

Gjeka me këtë poezi jo vetëm që kishte vënë në dyshim artificialitetin me të cilin Partia Komuniste ushqente rininë si dhe vetë letërsinë, por ai shkon më tej duke shprehur një mosbesim të hapur ndaj ideologjisë së kohës, duke kërkuar fundin e nënshtrimit, fundin e kuajve të bindur. Ai e ironizon deri në sarkazëm sistemin dhe slogonet e tij të njeriut të ri që rritej vetëm me ideale të partisë.

Gjeka tashmë kishte kapercyer atë që Rugova e quan si "hermetizëm lirik" të brezit të viteve 1970 i cili shfaqet në poezinë e brezit të poetëve të viteve 1970 në Shqipëri shtetërore sido që i kufizuar, ndërsa në Prishtinë në përmasa më të gjëra, si shprehës i botës individuale të kompikuar, si ndjenjë që poetët nuk e ndajnë qëllimisht me të tjerët, sepse ai është një qenie që përjeton një transformim shpirtëror të besueshëm dhe të paprekshëm.

Ky "hermetizëm lirik" i shfaqur tek Moikom Zeqo, Frederik Rreshpja, Xhevahir Spahiu, Anton Papeleka, Faslli Haliti, Skënder Buçpapaj, Sadik Bejko, Rudolf Marku, Sulejman Mato, Hamit Aliaj etj, është një ngjarje e përjetimit individual, human dhe jo si hermetizëm ideologjik, jo si platformë që synonte të vinte në pikëpyetje vështrimin e jetës plot shkëlqim të "metodës së realizmit socialist" apo si një tendencë për të mohuar atë. Ky brez poetik nuk ishte dizident, thjeshtë temat socialiste të jetës i përjetoi në mënyrë individuale, të mbyllur dhe shpesh hermetike.

Ndërsa poezia "Kujt" është një poezi disidente, ajo bën thirrje për rrëzimin e sistemit, duke demaskuar atë që letërsia e kohës e quante arritjen më të madhe të socializmit, njeriut të ri, i cili nuk ishte gjë tjetër vetëm një kalë cirku i bindur në arenën e madhe të socializmit totalitar.

5.

Brezi i viteve 1970 zbuloi si realizmi socialist, i variantit të Tiranës, kishte nxjerrë jashtë ndikimit fuqinë artistike të shprehjes, duke e lenë artin pa shpirt dhe ndjenjë, duke e politizuar atë që nga krijimi deri në interpretim, pra duke i hequr anën njerëzore dhe estetike.

Ndërsa poezia "Kujt" i kapërcen këta disidentë estetikë, ajo i kundërvihet hapur sistemit totalitar ndërsa ben thirrje për të dhënë fund nënshtrimit.

Ironia kuptimore është një mjet që përdoret me mjeshtri nga Marinaj për të shprehur mospajtimet e tij me disa fenomene të realitetit të kohës, sic ishte nënshtrimi fatal i njeriut ndaj eksperimentit shkarrimtar të komunizmit.

Ndërsa poezia e stërngazhuar e kohës ishte e mbyshur me fjalor konfirmues dhe stil fitoresh, Marinaja me poezinë Kujt futi në poezinë shqipe edhe një qëndrim kritik, mospajtimes dhe ironizues ndaj realitetit komu-



Në foto: Gjek Marinaj

nist. Deformimet që kishte pësuar sistemi përtej utopisë së përfolur kishte sjellë zhgënjime të njëpasnjëshme në jetën shoqërore dhe individuale sidomos të elitave të reja krijuese. Por rebelimi shoqëror po vonote. Qytetarët në Rumani ishin ngritur duke pushkatuar dikatorin komunist Causheku bashke me të shoqen, por kështu revolucioni demokratike kishte përfshirë gjithë kampin ish-komunist, ndërsa Shqipëria vijonte e nënshtruar si tek "Kujt" e Marinjat.

Ndryshe nga ironia shumëformëshe, përfshirë edhe ironinë fabulare që ndeshet tek disa poetë të Prishtinës si A. Podrimja, A. Shkreli, B. Musliu, S. Hamiti, R. Dedaj etj, në poezinë e Tiranës ndeshet me shumë një ironi poetike, figurative.

Poetët Xhevahir Spahiu, Faslli Haliti, Frederik Rreshpja, Mehmet Ekezi, Avni R. Mulaj, Ndoc Gjetja, etj, parapëlqejnë të ironizojnë



fenomene e sjellje njerëzore e shpesh burokratike.

Marinaj ironizon sistemin, zemren e rendit komunist, njeriun e ri. Kuajt godet fatalisht hipokrizinë dhe tjetërsimin shoqëror në shoqërinë totalitare.

KONKLuzion

E vështruar në çështjet thelbësore të saj, mendoj se poezia Kujt solli një numër risishë të identifikuar në këtë temë, krahasuar me brezat pararendës.

Kjo poezi, për shkak të natyrës së saj novatore mendoj se zë një vend të veçantë në poezinë shqipe të shekullit të njëzetë në tërësi.

Kjo poezi bëri denocimin e madh ndaj sistemit komunist i cili refuzoi ashpër çdo formë ndryshimi që kishin përfshirë vendet ish komuniste të Europës Lindore prej vjeshtës së vitit 1989, me rënjen e Murit të Berlinit.

Kjo poezi rezulton të ketë qenë një demaskim i sistemit dhe dhe nxitje e aspiratave të një brezi për ndryshim në letërsi, muzikë, teatër kinematografi, arkitekturë dhe në stilin e jetesës, dhe më kryesorja për ndryshime politike.

Kjo poezi e vetmja e këtij lloji e botuar gjatë 50 vetëve të regjimit komunist, mendoj se e përlligj interesimin e kritikës letrare, por edhe të studimeve, siç është edhe ky shkrim me të rejtat që solli në letërsinë shqipe dhe ndikimet afatgjata që pati në poezinë tonë dhe në jetën politike të vendit, në ngjarjet që u përfshi vendi në dhjetor të vitit 1990 me levizjen studentore antikomuniste.

Poezia kujt e Gjekë Marinjat për mendimin tim, ishte jo thjesht dicka ndryshe nga poezia skematike kohës, por edhe si një vokacioni i talentit të tij artistik që shprehej më mirë në këtë stil, në këtë frymë dhe ndërgjegje poetike.

"KUAJT"

Nga Gjek Marinaj

Tërë jetën duke vrapuar rrimë

Shohim veç përpara
Ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë.
Ne nuk kemi emër
Të gjithëve kuaj na thonë.
Nuk qajmë,
Nuk qeshim;
Heshtim,
Dëgjojmë;
Hamë atë ç'na japin,
Ecim nga na thonë,
Asnjë nga ne s'është mendje hollë.
Kush qe kalë mbreti,
Posti qe i lartë
Kush qe kalë princeshe
I bënë shalë të artë
Kush qe kalë fshatari
Pat samarë me kashtë
Kush qe kalë i egër
Tërë jetën fjeti jashtë.
Po qemë dhe mbetem kuaj, para njeriut

Marrë nga gazeta Drita 19 gusht 1990

Gjeka këtu bëri më të mirën e tij si poet duke shënuar diferencën me skamatizmin revolucionar të kohës. Marinaja është një poet i vetvetes, por edhe i së ardhmes që do të vinte pasi disa muajsh kur vendi u përfshi në revota dhe demonstrata të fuqishme për ndryshimin e sistemit pas dekadave të gjata të persekutimeve dhe ndalesave absurde..

Marinaj është një poet ëndërrimtar dhe utopist, ai si cdo poet mendon se poezia mund ta ndryshojë jetën dhe botën shqiptare dhe ashtu ndodhi më të veretë, poezia Kujt u lexua në cdo tribunë të levizjeve atikomuniste të të rinjve shqiptarë dhe punëtorëve shqiptarë dhe këtë e kam parë edhe vetë duke qenë dëshmitar dhe personazh i kësaj levizjeje.

Marinaj dhe brezi i tij dëshmuar një orientim origjinal poetik perëndimor, ishin një shembull i nxjerrjes së poezisë nga kufizimet ideo-estetike të kohës, dhe slogonet e kohës.

Nëse shkrimtarët në rajon dhe sidomos në ish-Jugosllavi, përjetuan një clirim të letërsisë nga kufizimet staliniste, pas ndërprerjes së marrëdhënieve të ish-Federatës së Titos, nga Bashkimi Sovjetik më 1948 dhe sidomos pas ardhjes në fuqi të Hrushovit e në vijim pas viteve 1960, për fat të keq Shqipëria mbeti me nervozizëm dhe besnikëri një ishull stalinist i kufizimeve të ashpra, dhe absurde.

Marinaj me poezinë "Kujt" identifikohet si një poet i lirisë dhe i revoltës qytetare kundër totalitarizmit. Ai përmes metaforës së kuajve të bindur, ironizoi nënshtrimin fatal ndaj diktaturës për shkak të frikës dhe masave shtërnguese që perdorte ajo. Poezia, nxiti revoltën, ngritjen krye kundër shtypjes staliniste, evokoi lirinë si një ndjenjë të përbotshme kundër nënshtrimit, cfarë e bën atë një poezi të gjithëkohshme dhe vetë Marinajn një poet universal.

Bordi Editorial Nderkombetar i revistës "Nacional"

1. Prof. Dr. Frederick Turner (USA), (Professor, UTD)
2. Prof. Dr. Ed Garcia (USA), (Professor, retired)
3. Dr. Rati Saxena (India), (Drejtoreshë e revistes "Kritya")
4. Mai Van Phan (Vietnam), (Poet Professional, Vietnam)
5. Prof. dr. Vasil Tocinovski, Shkup/Skopje
6. Akademik Fabijan Lovriç (Prof. Dr), Knin, Kroaci
7. Prof. Dr. Basil Schader Zvicer, Universitetit i Cyrihut, albanolog
8. Prof. dr. Gjovalin Shkurtaç, Akademik, Tiranë

9. Prof. Dr. Milazim Krasniqi, Universiteti i Prishtinës
10. Prof. Dr. Albin Sadiku, Qendra Albanologjike, Prishtine
11. Prof. Dr. Shaban Sinani, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë
12. Prof. Dr. Ardian Marashi, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë
13. Prof. As. Dr. Ukë Bucpapaj, Univeriteti i Tiranës
14. Prof. Dr. Nuridin Ahmeti, (Hulumtues në Degën e Historisë)
15. Prof. Dr. Sadik Bejko, Universiteti i Tiranës
14. Dr. Nail Draga, Ulqin, Mail i Zi

15. Pr. Dr. Avzi Mustafa, Universiteti i Shkupit
16. Michael Agustin, Gjermani
17. Naim Araidi, poet, Izrael
18. Dr. Rovena Vata, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë
19. Prof. As. Dr. Anton Papeleka, Tiranë
20. Prof. Dr. Bahri Beci, Tiranë
21. Prof. Dr. Klara Kodra, Tiranë
22. Prof. Dr. Laura Smaçi, Qendra e Stud. Albanologjike, Tiranë